



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 56, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2,433,796 (DY MILIONË E KATËRQIND E TRIDHJETË E TRE MIJË E SHTATËQIND E NËNTËDHJETË E GJASHTË) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI EDEN-ECOLOGICAL DEVELOPMENT THROUGH FARMING FOR ENHANCING THE URBAN ENVIRONMENT, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027)

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 65/2022, "Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)", Ligjit nr.8/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027", Udhëzimit nr. 10, datë 12.07.2024, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit udhëheqës së Projektit Bashkia Konversano/Municipality of Conversano (Itali) dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01.09.2025, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Turizmit për alokimin e fondeve të parafinancuara nga projekti EDEN - Ecological Development through farming for enhancing the urban Environment (Zhvillim Ekologjik përmes bujqësisë për përmirësimin e Mjedisit urban), programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027), me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 2,433,796 (dy milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, të ardhura si parafinancim nga fondet e programit Interreg IPA SOUTH ADRIATIC, Projekti EDEN, me kod produkti G107009, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
	2	Arsimi bazë përfshirë parashkoll-orin	231	09120	2107001	Bashkia Durrës	Projekti EDEN	G107009	2,433,796

2. Ky fond do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve për vitin 2026 e në vazhdim, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale dhe ndërkombëtare, udhëtime jashtë vendit, materiale promocionale, kancelari dhe përkthim/noterizim.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETARE
Denisa Luarasi

U shpall sot me datë 20.07.2026




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 566/₄ prot.

Durrës, më 27.07.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.56 datë 17.07.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 2,433,796 (dy million e katërqind e tridhjetë e tre e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë të parafinancuara nga projekti EDEN-ECOLOGICAL DEVELOPMENT THROUGH FARMING FOR ENHANCING THE URBAN ENVIROMENT, program INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027).

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

